



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br. 93/21
Nr. i sq. / Br. st. - 6 -
Datum / Datum 29. 04. 2021
VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 2 PRILL 2021**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 14:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrris:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ymeri, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fitim Halili, Faton Shabani, Gresa Muli, , Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Ilir Krasniqi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Miljan Bojković, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Syla Teuta Aruç Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Munguan: Agim Krasniqi, Gentiana Rama dhe Ismet Hajrizi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 32 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z.Xhafer Tahiri nënkyetari i komunës z. Afrim Namani, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, mund të ketë debat për rendin e ditës por ai nuk mund të ndryshohet, andaj kërkoi nga kryesuesi që hapet debatin.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-tha se pushteti e ka për ngutë këtë çështje dhe për atë edhe ka kërkuar mbledhje të jashtëzakonshme, kjo po dihet fare mire se përsë dëshiron që këtë çështje ta tejkaloj shpejt e shpejt. Grupi kuvendar i PDK-së, po kérkon debat lidhur me pikën e rendit të ditës për të marr një vendim dhe jo për ndryshim të rendit të ditës, edhe pse ka pasur praktika dhe raste më herët kur është ndryshuar rendi i ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se Procedurat e njëjta që kerkohen për njoftimin dhe çështjet e tjera që zbatohen për mbledhjet e rregullta, zbatohen për mbledhjet e jashtëzakonshme gjithashtu. **Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-arsyetoj** se thirrja e kësaj mbledhje të jashtëzakonshme është bërë me qëllim të shterjes së debatit, lidhur me vendosjen e bizneseve në zonën ekonomik në

Lumadh. Kemi dashur që të jetë mbledhje e jashtëzakonshme sepse asnjëherë Komuna e Vushtrrisë nuk ka pasur zonë ekonomike dhe vetë kjo ngjare me rëndësi të veçantë është çështje e jashtëzakonshme. Arsyja tjetër është sepse tani bizneset duhet ti fillojnë investimet dhe kësijo nuk ka kohë për të humbur. Ai sqaroi me tej se procesi i përzgjedhjes së operatorëve është bërë në mënyrë plotësisht transparente ka kanë marrë pjesë pozita dhe opozita dhe është monitoruar nga BIRN. Andaj ai kërkoi që të qitet në votim rendi i ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se nuk duhet që kryetari i komunës të interferoj në punën e kuvendit, sepse Ligji për Vetëqeverisje Lokale, iu mundëson anëtarëve të kuvendit që të debatojnë për një pikë të rendit të ditës, dhe kërkoi nga kryesuesi i kuvendi që të menaxhoj si duhet mbledhjen e kuvendit. Në vazhdim ai shtoi se para disa ditësh kemi pranuar një kërkesë nga kryetari i komunës për mbledhje të jashtëzakonshme, pa asnje konsultim paraprak me grupet kuvendare, edhe pse asnjëherë më shumë nuk ka pasur nevojë të debatohet për këtë çështje dhe të gjendet një konsensus politik për këtë projekt. Grupi kuvendar i PDK-së vlerëson se kjo çështje nuk është me urgjencë, pasi në Parkun Industrial në Lumadh ka ende punë që duhet përfunduar, dhe kësijo kjo zonë akoma nuk është e gatshme për vendosjen e bizneseve, si do që të jetë kjo mbledhje është thirrur me urgjencë dhe me një pikë ekskluzive vendosje e bizneseve në parkun industrial në Lumadh. Ai sqaroi se pjesë e komisionit për vlerësimin e ofertave ishte edhe vet ai, dhe falënderoj të gjithë koleget anëtar të komisionit për punën e mirë që kanë bërë. Po ashtu falënderoi përfaqësuesit e BIRN-it, për monitorimin e këtij procesi, me çka anëtaret e komisionit kanë qenë më të lehtësuar në kryerjen e detyrave të tyre. Puna e përbledhur e komisionit është adresuar në rekomandimin final që tani është duke u trajtuar, ku ceket se vlera investive e këtij projekti është 22,000.000 € dhe rreth 800 vende të reja të punës gjë e cila është për tu përshëndetur. Grupi kuvendar i PDK-së, ka mbajt mbledhje enkas për këtë çështje për tu dakorduar për këtë çështje, dhe ka vlerësuar se kjo mbledhje e kuvendit nuk i plotëson kushte ligjore si mbledhje e jashtëzakonshme pas nuk është respektuar afati ligjor i thirrjes së saj dhe dërgimit të materialeve që është tri ditë pune. Andaj si do që të jetë edhe po të votohej kjo pikë do të rezultonte e kundërligjshme, sipas vlerësimeve të MAPL-së. Pastaj sqaroi se ftesa është dërguar e vetme pa materiale përcjellëse që janë objekt shqyrtimi, ndërsa materialet janë dërguar pas dy ditët me post elektronike por jo edhe si kopje fizike. Sipas kësaj tani jemi në ditën e dytë të rrjedhjes së afateve ligjore lidhur me këtë mbledhje, dhe sipas kësaj kjo mbledhje do të kishte legjitimitet sikur të mbahej me datën 6 prill 2021, pasi data 3 dhe 4 nuk janë ditë pune. Në referim edhe të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme administrative lidhur me afatet përcakton: 1. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, afatet do të përcaktohen në ditë, muaj apo vite. Mbarimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike. Paragrafi 2. Kur afati përcaktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodh ngjarja nga e cila fillon të ecën afati, andaj e vërteta është se tani jemi në ditën e dytë të rrjedhje së afateve lidhur me këtë seancë. Në fund nga të cekurat më lart grupi kuvendar i PDK-së kërkon që kjo mbledhje e kuvendit të mos mbahet pasi nuk janë plotësuar kushtet ligjore që dalin nga dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës dhe rregulloren e punës.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se nëse do ishte thirr një mbledhje e jashtëzakonshëm për diskutim për pandeminë covid-19 do të kishte pasur arsy, por të mbahet takim i jashtëzakonshëm për këtë çështje nuk është se është e nevojshme, pasi kjo temë do mund të trajtohet në mbledhje të rregullt, ka edhe shumë tema që nuk dëshiron ti ngrit në këtë mbledhje.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se është e vëmja praktikë në Republikën e Kosovës, që vendosjen e biznesit në një zonë ekonomike e kemi bërë në transparencë të plotë, ku ka marr pjesë pozita dhe opozita dhe procesi është mbikëqyrur edhe nga BIRN, dhe që praktikisht nuk kemi as

edhe një ankesë të vetme sa i përket procedurave të ndjekura me rastin e vendosje së bizneseve në zonën ekonomike, arsyetimi se nuk janë ftuar grupet kuvendare para se të thirret kjo mbledhje e jashtëzakonshme nuk është arsyse sepse përfaqësuesit e secilit grup kuvendar kanë qenë pjesë e komisionit për vendosje në zonë ekonomike edhe përfaqësuesi i PDK-së edhe i LVV-së por edhe shoqëria civile, dhe të gjithë këta bashkë kanë sjell një rekomandim për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike. Mbledhjen e jashtëzakonshme e arsyetoj me faktin se kjo është një ngjarje e jashtëzakonshme e cila duhet dhe publicitetin e merituar sepse po bëhet paraku industrial me investime 22,000.000 € dhe afër 800 vende të reja të punës. Të thuash se nuk është urgjente vendosja e biznesit në zonën ekonomike në një kohë të krizës kaq të madhe për biznesin Vushtrrias është tepër e paqëndrueshme. Tani po shihet se ka një marrëveshje të fshehtë mes LVV-së dhe PDK-së, për ta penguar këtë projekt, nëse kështu kanë vendosur atëherë le të jetë ashtu, por le ta dinë të gjithë qytetaret se ai nuk ka qenë i përfshirë në procesin e përgjedhjes së bizneseve për atë zonë ekonomike. Nëse merren për bazë komuna tjera, për kësi lloj projekteve atëherë lirisht mund të thuhet se Komuna e Vushtrrisë është shembull për transparencë që ka pasur sa i përket këtij procesi. Vlerësimi se zona ekonomike është akoma e papërfunduar është i paqëndrueshëm sepse ka mbetur vetëm asfalti të shtrohet dhe të përfundojnë punimet sa i përket këtij paraku industrial. Ai vuri në dukje se ky projekt është historik për Vushtrrinë, pasi për herë të parë Vushtrria po bëhet me zonë ekonomike në kushte krize dhe të ikjes së investitorëve. Licencimi në kohe rekorde dhe zhvilli i projekti me një dinamikë të larët është për tu krenuar. Lidhur me ligjshmërinë e mbledhjes konstatoj se ftesa për thirrje të mbledhjes është tërësisht ligjore dhe këtë mund ta konstatoj edhe Sekretaria e Kuvendit. Andaj tendenca për ta shtyrë këtë mbledhje është obstruksion politikë i PDK-së dhe LVV-së dhe kjo ndikon keq tek investitorët dhe zhvillimi i biznesit, pengimi i këtij projekti është në përgjegjësi të anëtarëve të kuvendit të cilët po e bllokojnë këtë proces.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-apeloj tek kryetari i komunës që mos ti përdor qytetaret dhe vendet e punës për qëllimet e tij politikë, pasi LVV ka punuar, për këtë projekt për gati 3 vite dhe ka hisen e saj të kontributit, por e vërteta është se ka shumë ankesa për keqpërdorim dhe ankesa se përsë nuk iu është dhënë mundësia edhe bizneseve tjera për tu vendosur në këtë zonë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se edhe më herët kishte deklaruar se sa herë që kryetari i komunës sjell diçka në të mirë në të qytetarëve atëherë ai do ta përkrah, dhe se në këtë moment patjetër se do të jetë pro këtij vendimi. Ai shtoi se nuk e kuption qasjen e LVV-së dhe të PDK-së, se përse tani kundërshtojnë kur që të dyja këto subjektet i kanë pasur anëtarë e tyre në kromosnin vlerësues për dhënien e këtyre pronave në shfrytëzim. Pastaj shtoi se duhet pasur kujdes që edhe atëherë kishte kërkuar të bëhet harmonizimi i komisionit vlerësues, pasi që në bazë të Ligjit dhe Dhënen në Shfrytëzim komisioni duhet të ketë pesë anëtarë, ndërsa komisioni ka pasur shtatë anëtarë. Lidhur me kontestimin e mbledhjes shtoi se nga fillimi ka kërkuar që materialet të vijnë me kohë, por që kanë qenë të njëjtë anëtar që sot po kundërshtojnë që atëherë i kanë përkrahur këto praktika. Kërkojë që në propozim-vendim të inkorporohen edhe emrat e pronarëve të këtyre bizneseve që janë përfitues të pronës në zonën ekonomike. Në fund apeloi tek të gjithë ata anëtar të kromosnit por edhe të kuvendit, që me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit të mos jenë pjesë e votimit dhe vendimmarjes.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se kjo mbledhje e kuvendit nuk është thirrur sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dhe për mbajtjen e saj nuk janë plotësuar kushtet ligjore andaj propozoi që kjo mbledhje mos të mbahet apo e njëjtë të ndërpritet. Andaj kërkoi opinion ligjor nga Zyra Ligjore e Komunës, se a mund të mbahet kjo mbledhje apo jo.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-në cilësinë e kryetarit të komisionit për vlerësimin e ofertave lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale në Parkun Industrial në Lumadh, pasi falënderoi anëtarët e komisionit, sqaroi se procesi i përzgjedhjes së këtyre bizneseve është plotësisht transparent dhe i monitoruar nga BIRN, dhe mund të thuhet se të gjitha procedurat janë konform legjislacionit në fuqi, shpalljet janë në faqen zyrtare të komunës, ka qenë afati i ankesave, ka qenë adresa e saktë se ku duhet adresuar ankesat, kanë qenë përcaktuar saktë kriteret që është dashur të plotësohen nga bizneset, ndërsa lidhur me mbledhjen e kuvendit ai potencoi se ftesa e për mbledhje ka shkuar sipas afateve ligjore.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-tha se dispozitat e ligjit në analogji përcaktojnë se të njëjtat procedura që zhvillohen për mbledhjet e rregullta të njëjtat zhvillohen edhe tek mbledhjet e jashtëzakonshme, andaj në këtë rast kemi vonesa në dërgimin e materialeve dhe mos respekt të procedurave. Ai për pos tjetra shprehu se ka ankesa jo vetëm nga ata që nuk janë përzgjedhur si përfitues por ka edhe prej atyre që janë përfitues të pronës e që kanë ankesa nëpër instancë të ndryshme ligjore, andaj ai propozoi që kjo mbledhje të shtyhet deri sa të zgjidhen këto dilema.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit-në cilësinë e anëtarit të komisionit vlerësues, ceku se vërtet është bërë një punë e mirë në përzgjedhjen e operatorëve ekonomik, dhe për këtë ka ekzistuar edhe afati i ankesave, në këtë kontekst ai ftoj të gjitha grupet politike që ta përkrahin këtë projekt i cili është me rëndësi të veçantë për Komunën dhe qytetarët e Vushtrrisë.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-tha se grupi kuvendar dhe Partia Demokratike e Kosovës, gjithherë ka mbrojtur e përkrahur interesin e përgjithshëm qytetar. Në momentin ku shohim se rruga e adresimit të interesit të përgjithshëm qytetar është devijuar atëherë PDK nuk do të jetë në atë linjë dhe do të thotë jo keqpërdorimeve dhe sjelljeve e veprimeve korruptive. Ky kuvend nuk e ka legjitimitetin për të vendosur ani pse ka legalitetin dhe kornizën ligjore për ti aprovuar apo refuzuar propozimet e qeverisë komunale. Sot shohim një nguti të kryetarit të komunës dhe stafit të tij për ta quar përpara këtë çështje, sepse atyre nuk po ju pritet sepse e kanë të qartë se kurrë më nuk do të janë në këto ulëse në cilat gjenden sot. Ai me patjetër i shpreh opozitën edhe atyre të cilët për tri vitet e gjysmës kanë shijuar të mirat e pushtet kanë realizuar interesa private dhe personale dhe tanë mundohet ta justifikojnë veten e tyre. Në fund tha se në shenjë të refuzimit të krimit e korruptionit, që e ka katandisur qytetin ai nuk do të jetë pjesë e kësaj mbledhje dhe ftoj të gjithë anëtarët e kuvendit që ta bëjnë një gjë të tillë.

Në vazhdim grupi kuvendar i PDK-së në mënyrë demonstrative lëshoj sallën e mbledhjes, duke braktisur punimet e seancës plenare të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se për të gjithë ata të cilët ngitenakuza dhe shqetësime për krim dhe korruption ai fton organet e drejtësisë prokurorinë e shtetit që ta bëjnë punën e tyre dhe ti hetoj ato çështje. Por nuk është mirë të përdoren këto forma për ta bllokuar këtë projekt. I ftoj partitë opozitare PDK-në dhe LVV-në, që mos të ikin nga përgjegjësia, por të qëndrojnë në sallë dhe të debatojnë, duke ikur nga salla me pretendimin se kështu e pengojë punën e kuvendit është një dëm i jashtëzakonshëm për ekonominë e qytetit për bizneset dhe për vendet e reja të punës në Komunën e Vushtrrisë. Duke ikur nga mbledhje mendojnë se kështu do ti fitojnë votat për ta marrë pushtetin në komunë, dhe për ti kryer këto proceduar ashtu si dëshirojnë ata. Ai ftoj anëtarë e kuvendit që të qëndrojnë në sallë dhe ta përkrahin këtë projekt.

Nasuf Aliu, kryesues i Kuvendit-konstatoj se në mbledhje janë prezent 21 anëtar të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për të vazhduar punimet e mbledhjes.

Pas debateve kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë e hodhi në votim rendin e ditës, 11 anëtarë të kuvendit votuan “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim, pastaj doli në votim propozimi tjetër për shtyrjen e mbledhje për të cilinë 9 anëtar të kuvendit votuan “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim.

Kësisoj, kryesuesi i kuvendit nuk nxori ndonjë konstatim se a ishte aprovuar rendi i ditës apo jo.

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për vlerësim të ofertave përvendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Lumadh.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-kërkoi nga kryetari i komunës që mos të interferoj në punën e kryesuesit të kuvendit në udhëheqjen e mbledhjes. Pastaj ajo vlerësoi se projekt i Parkut Industrial, është tepër me rëndësi të veçantë dhe i njëjtë është iniciuar nga Drejtoria për Ekonomi të cilën e kishte udhëhequr Lëvizja Vetëvendosje. Andaj pikërisht për shkak të rëndësisë së këtij projekti, nuk duhet votuar pa qenë prezent të gjithë anëtarët e kuvendit duke përfshirë edhe ata të LDK, që po e sabotojnë kryetarin e komunës por edhe anëtaret e tjerë të kuvendit. Lidhur me transparencën e këtij procesi ajo vlerësoi se momenti më i rëndësishëm është ai i shpalosjes së dokumentacionit, dhe po atë ditë ka munguar anëtari i komisionit nga radhët e LVV-së i cili ka qenë i sëmurë duke luftuar me vdekjen nga virusi covid-19, po ashtu ka munguar monitoruesi i BIRN-it, andaj përzgjedhja e dokumentacionit atë ditë është bërë vetëm nga përfaqësuesit e PDK-së dhe LDK-së, dhe nga përfaqësuesi i shoqërisë civile i cili edhe ai ka konflikt interesit sepse gjenden në raporte krushqie me njërin nga anëtaret e këtij komisioni. Komisioni vlerësues është dashur të jetë më gjithëpërfshirës sepse aty kanë qenë të përfshirë 3 anëtar nga radhët e LDK-së, andaj kjo dhe të tjerat duhet të merren përbazë nga ana e kryetarit të komunës, dhe duke qenë të pranishëm të gjithë anëtaret e kuvendit të votohet ky projekt madhor në të cilin ka hise Lëvizja Vetëvendosje. Ajo propozoi që kjo mbledhje të shtyhet për një ditë tjetër duke i përmbrushur të gjitha ato që i tha më lart dhe duke qenë prezentë të gjithë anëtaret e kuvendit.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se nëse dëshirojmë të jemi në anë e interesit qytetar atëherë duhet qëndruar në sallë e kuvend për ta bërë kuorumin, jo të bëjnë koalicion me PDK dhe të tentojnë ta pengojnë këtë projekt.


Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit-tha se ankesat dhe shqetësimet e aplikueseve për zonën ekonomike, janë të njëjtat sikurse i proklamuan edhe anëtaret e PDK-së, andaj vlerësoi se duhet zgjidhjen këto dilema e mandej të votohet ky projekt, propozoi që të shtyhet mbledhja e kuvendit.

Në vazhdim grupi kuvendar i LVV-së në mënyrë demonstrative lëshoj sallën e mbledhjes, duke braktisur punimet e seancës plenare të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-në cilësinë e kryetarit të komisionit përvlerësimin e ofertave lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale në Parkun Industrial në Lumadh, bëri prezantimin e këtij projekti, duke shtuar se është investimi më i madh në ekonominë

e qyteti, dhe fatkeqësish tendenca për ta politizuar këtë projekt është për keqardhje. Pastaj ai sraqoi pozitën gjeografike të këtij projekti, ku vlerësoi se vetë ndodhja dhe distanca me dy qyteteve e bënë këtë parak industrial tepër atraktiv për investim dhe zhvillim. Zona Industriale, në Lumadhdh është e inkorporuar në Planin Zhvillimor Komunal 2016-2024 dhe po ashtu kjo zonë ka qaje edhe në rrugën magjistrale M2, ndërsa zona rreth e rrotull është e mbyllur me muri, ndërsa në pjesën e sipërme do të vendoset rrethojat. Numri total i aplikuesve për këto prona është gjithsej 43 biznese, 22 biznese kanë plotësuar kriteret sipas konkursit, ndërsa 21 prej tyre nuk i kanë plotësuar këto kritere, nga kjo del se 50 % e bizneseve që kanë aplikuar në Parkun Industrial në Lumadhdh janë përzgjedhur. Totali i investimeve që parashihet të bëhet nga këto 22 biznese është mbi 22,000.000 €. Nga ky projekt parashihet të hapen rreth 813 vende të reja të punës. Prej këtyre 18 biznese janë me veprimtari prodhuese, 3 biznese janë me veprimtari prodhuese-përpunuuese, ndërsa 1 biznese është me veprimtari prodhuese-shërbysese. Të gjitha këto biznese të përzgjedhura kanë ofruar dokumentacionin e kërkuar sipas konkursit: formularin e kërkuar me të dhënrat për aplikim, certifikatën e regjistrimit të biznesit, historiatin e kompanisë, veprimtarinë që do ta zhvilloj dhe projektin ideor. Bizneset përfituese në tri (3) vitet e para nga data e nënshkrimit të kontratës me komunën, nuk do të paguajnë kompensim, ndërsa pas tri (3) viteve do të paguajnë 0.05 € (pesë cent) për m² në vit. Prona komunale iu jepet në shfrytëzim në afat prej nëntëdhjetë e nëntë (99) viteve. Të gjitha bizneset do të kenë qasje në infrastrukturën e parakut industriale, ashtu që nuk do të kenë kurrrfarë pengesash në zhvillimin e aktiviteteve të tyre. Projekti i ndërtimit të Parkut Industrial në Lumadhdh infrastruktura është financuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë vlera e investimit është 1.8 milion euro.

Kryesuesi i kuvendit Nasuf Aliu, konstatoj se në sallën e kuvendit gjenden 10 anëtarë të kuvendit, andaj duke u bazuar në nenin 29 të Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Organeve të tij, ku thuhet kur gjatë mbledhjes numri i anëtarëve të kuvendit bie nën numrin e paraparë për mbajtje të mbledhjes dhe marreje të vendimeve e mbylli mbledhjen në ora 15:05.

Bastri Duraku

Procesmbajtës

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit
